



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Olti&Kenza shpk” të datës 16.05.2025 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 12.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi i objekteve për rezidentët e SHPMPF” me nr. të prokurimit 616-25-2379-2-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Olti&Kenza shpk” të datës 16.05.2025 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 12.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi i objekteve për rezidentët e SHPMPF” me nr. të prokurimit 616-25-2379-2-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Olti&Kenza shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 16.05.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 12.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi i objekteve për rezidentët e SHPMPF” me nr. të prokurimit 616-25-2379-2-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: *"Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit ,ku kerkohej sqarim e tenderit si ne vijim Keni nje mosperputhje ne cmimin e ofruar:ne Formularin e ofertes eshte dhene shuma prej 19,440.00 euro kurse ne paramase eshte paraqitur nje cmim tjetër prej 19,400.00 eurove duke krijuar nje diference prej 40.00 eurove qe eshte mbrenda kufijve ne marzhen e gabimeve aritmetike prej 2%. Andaj kerkojme nje sqarim per kete cmim dhe te njoftoni AK-ne per cmimin perfundimtar a eshte i Formularit apo Paramases. Ne ju kemi derguar sqarim me daten 01.05.2025 me nje deklarate derguar juve dhe te bashkangjitur edhe paramasen".*

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Kjo oferte refuzohet sepse sipas A01 Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Neni 40 pika 40.10 b. në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet.

Parashtruesi parimisht nuk e konteston faktin që ekziston çmimi në formularin e tenderit dhe në paramasë nuk përputhet mes vete. Mirëpo parashtruesi pretendon se kjo mospërputhje është më e vogël se 2%. Sa i përket devijimit prej 2%, kjo klauzolë e RRPP në të cilën aludon parashtruesi i referohet gabimeve aritmetikore që mund të ndodhin përbrenda paramasës dhe mund të korrigjohet nga vet AK mirëpo vetëm në raste të caktuara, në formën dhe duke respektuar procedurën e caktuar. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gabime aritmetikore të kalkulimit në paramasë por kemi të bëjmë me mospërputhje të cmimit në paramasë dhe formular të tenderit. Lidhur me këtë situatë, RRPP përmes nenit 40.10 pikës b) sqaron se *"Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, **oferta refuzohet**"*. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 19.05.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.